Kjo zgjidhje eshte kerkuar si optimalja, duke patur parasysh ngarkesen e paisjeve qe do te instalohet ne kabinet. Me kete koncept ftohje, garantohet ftohja e paisjeve brenda kabinetit, por nga ana tjeter ajri i ngrohete mbetet ne mjedis (teknisht njesia ftohese duhet te garantoje ftohjen ne kapacitetin minimal 3.1kW, edhe kur temperature e ambientit/dhomes shkon deri ne 50 °C). Per te shmangur, akumulumin e ajrit te ngrohete brenda ne dhome, do te instalohet nje sistem ajrimi/aspirimi qe ben shkarkimin/heqjen e ajrit te ngrohete nga dhoma ne ambientin e jashtem te godines. Per kete qellim, ne murin e dhomes nga faqja e jashteme e godines do te instalohet nje ventilator centrifugal dhe grila kundra shiut. Nderkohe ne anen tjeter te murit, do te instalohet nje ventilator aksial qe ben te mundur futjen e ajrit ne dhome.

Ventilatori centrifugal, do te lidhet me sistemin e menaxhimit dhe kontrollit, dhe do te hyje ne pune, sa here temperature ne dhome shkon 28° C (setpoint duhet te jete i programueshem, ne menyre qe te ndryshohet gjate veres dhe dimrit).

### **Sistemi i Dedektimit dhe Shuarjes se Zjarrit**

Sistemi i dedektimit dhe shuarjes se zjarrit do te jete nje njesi autonome e montueshme ne rak (ne Rack Unit 42), dhe do te kete te integruara te gjitha komponentet e nevojshme per dedektim, sinjalizim dhe shuarje te zjarrit.

Sistemi i dedektimit dhe shuarjes se zjarrit duhet te përbëhen nga:

- Rezervuari (cilidri) qembanagjentin e shuarjes. Rezervuariduhet te jete i perberenga material celiku. Vellimi i rezervuaritduhet te jeteminimalisht 2kg.
- Agjentin e shuarjes; mjafton te jeteagjent i paster, qenukdemtonnjerezitdhepaisjetkompjuterike.
- Instrument mates per nivelin e agjentit te shuarjes. Ky instrument duhet per monitorimin e vazhdueshem te sasise se agjentitshuares ne cilindër, dhenesenivelibienenkufirin e duhur, atehereautomatikishtpaneli i kontrollitduhet te gjenerojenje alarm.
- Valvulesigurie (mbipresioni), per te mbrojtursisteminnesekaproblemecilindriaponesepaisjambinxehet.
- Pompa, ne menyreqe te pompojeagjentinshuaresjashterezervuaritdhe me pas agjentishuaresdrejtohetnepermjettubacionevehermetike.
- Valvulaelektromagnetike, qe ben sprucimin me presion ne drejtim te nozoles (pikadalese e agjentitshuares ne ambient).
- Celespresioni, per te kontrolluarpresioninnedalje te pompes.

- Dedektortymi; ajri, bashke me materialin e djegies (tymin) thithetdhedrejttohet per ne dedektor, nepermjetnjeventilatori radial.
- Bateri per te garantuarautonome e punes se sistemitdhenerast se eshteshkeputurngapunaburimiprimar i energjise.
- Paneli i kontrollit, i cilimblehdheperpunonsinjaletnga te gjithasensoret (te brendeshemdhe te jashtem), siedhekomandonpaisjet e sinjalizimitdheagjentinshuares.
- Butonat e kontrollit manual, siedhepasijetlokale te sinjalizimit.

Specifikimet teknike te njesise duhet te jene si meposhte:

Parametrat e sistemit te dedektim dhe shuarje zjarri	
Aktivizimi	<p>Automatik dhe manual</p> <p>Njesia duhet te akvizizohet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Automatikisht nga sensori i brendshem.</li> <li>▪ Nga nje buton manual i jashtem.</li> <li>▪ Nepermjet nje komande nga rrjeti nga IP</li> </ul>
Hyrjet	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Porte rrjeti IP.</li> <li>▪ 2 hyrje per sensore te jashtem.</li> <li>▪ 2 kontakte dixhitale per sensore te jashtem te ndryshem.</li> <li>▪ 1 hyrje per buton aktivizimi manual.</li> <li>▪ 1 kontakt dixhital, per te penguar shkarkimin e agentit nese dera e kabinetit eshte e hapur.</li> </ul>
Daljet	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ 4 dalje rele NO/NC</li> <li>▪ 1 dalje per sirene te jashteme.</li> </ul>
Sinjalizimi Lokal	<p>Njesia duhet te kete sinjalzim LED ne pjesen ballore, te cilat duhet te sinjalizojne:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Paisje eshte ne gjendje pune, apo ne testim (komisionim apo mirembajtje)</li> <li>▪ Nese sirenat jane ne gjendje pune, te shkeputura, apo te c'aktivizuara.</li> <li>▪ Nese sistemi eshte ne gjendje pune, apo ne alarm.</li> <li>▪ Nese shuarja eshte ne proces, apo ka perfunduar.</li> <li>▪ Nese shuarja eshte bllokuar, nga nje sensor i jashtem (psh: dera e hapur)</li> <li>▪ Nese nje dedektor tymi eshte ne gjendje "fault".</li> <li>▪ Nese pompa eshte ne gjendje pune normale, apo ne alarm (fault).</li> <li>▪ Nese valvula eshte e hapur, apo ne alarm (fault).</li> <li>▪ Nese burimi i ushqimit eshte ne gjendje normale, apo energjia eshte nderprere.</li> <li>▪ Nese bateria eshte e lidhur, eshte ne karikim, eshte ne gjendje pune, apo eshte ne testim.</li> <li>▪ Nese ventilatori eshte ne gjendje normale pune,</li> </ul>

	eshte ne alarm (nuk rrotullohet).
Menaxhimi dhe operimi	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Manual nepermjet butonave, dhe sinjalizimeve ne trup te njesise.</li> <li>▪ Menaxhim dhe operim, nepermjet nje nderfeqje Web nepermjet rrjetit IP. Nepermjet nderfaqes web, duhet te mundesohet i gjith kontrolli i paisjes; monitorimi i gjendjes se komponenteve (njelloj si ne sinjalizimin lokal), konfigurim i hyrje/daljeve si NO apo NC, aktivizim nepermjet Webit i agjentit shuares.</li> <li>▪ Dergim te njoftimeve me email, dhe me SNMP</li> </ul>
Dimensionet	E montueshme ne Rack

### **Sistemi i Monitorimit dhe Kontrollit (BMS)**

Qëllimi i ketije sistemi eshte monitorimi, menaxhimi, kontrolli dhe ndërveprimi të unifikuar i te gjitha komponenteve te dhomes se serverave, ne nepermjet nje nderfaqeje te vetme. Sistemi do te perfshije momentalisht sistemet qe jane pjese e ketije projekti, por duhet te kete kapacitetet per shtimin e paisjeve te tjera ne te ardhmen.

Ky sistem mund te ndahet ne keto komponente kryesore (gjithsesi arkitektura mund te ndryshoje ne varesi te sistemit qe ofrohet):

- Kontrolleri
- Modulet e I/O (Hyrje/Daljeve)
- Softi i Operimit

### **Kontrolleri**

Kontrolleri eshte njesia qendrore e te gjithë sistemit te monitorimit dhe menaxhimit. Ne kete paisje duhet te lidhen te gjitha dedektoret si edhe nepermjet saje duhet te behet integrimi i sistemeve te tjerave.

Kontrolleri duhet te ofroje parametrat e meposhteme:

- Te suportoje IP, ModBUS master/slave, Modbus RTU, Modbus TCP/IP dhe SNMP
- Te kete 8 porta per te lidhur dedektore te ndryshem inteligjent
- Te kete minimalisht 8 kontakte (DI)
- Te kete nje porte per zgjerim te sistemit, per te shtuar module I/O
- Te kete modul per njoftim me SMS

Kontrolleri duhet te kete webserver te integruar, per konfigurim dhe operim lokal, duhet te kete “data logging” te integruar dhe te ruaje trendin/historikun e sistemeve apo sensoreve lokalisht.



Ne dhomen e serverave do te monitorohen gjithashtu parametrat ambjental te punes, si temperature, lageshtia, si edhe dedektimi i prezences se ujit.

Sensori i temperatures dhe lageshtise do te instalohet ne rack, ndersa dedektori i prezences se ujit do te instalohen ne dyshemene e dhomes, dhe specifikisht do te shoqeroje tubin e drenazhimit te njesise ftohese. Dedekoret e temperatures dhe lageshtise relative, mund te jene dy dedektore te ndare, ose mund te jete nje dedektore i kombinuar qe monitoron te dy parametrat.

Te gjitha dedektoret duhet te lidhen ne kontrollerin e sistemit te monitorim dhe menaxhimit te dhomes (sistemit BMS).

### **Dedektore Temperature dhe Lageshtise Relative**

Dedektori temepratures dhe lageshtise relative, duhet te instalohen nje per secilin rack. Dedektoret mund te lidhen secili vecmas ne nje porte te kontrollerit ose mund te lidhen zinxhire.

Specifikimet teknike te dedektoreve duhet te jene si meposhte:

Parametrat e dedektoreve te temperatures dhe lageshtise relative	
Diapazoni i matjes se temperatures	Nga $-55^{\circ}\text{C}$ ne $+75^{\circ}\text{C}$
Rezolucioni i matjes	$1^{\circ}\text{C}$
Saktesia e matjes	$\pm 0.2^{\circ}\text{C}$ per temperature nga $-10^{\circ}\text{C}$ deri ne $+75^{\circ}\text{C}$
Diapazoni i matjes se lageshtise relative	Nga 0% ne 100%
Rezolucioni i matjes	0.5%
Saktesia e matjes	$\pm 5\%$ ne temperature $25^{\circ}\text{C}$
Furnizimi me energji	Nga kontrolleri

### **Dedektore i Prezences se Ujit**

Dedektori i prezences se ujit duhet te jete ne forme lineare (litari) me gjatesi minimalisht 3m, per arsye se do te instalohet nen dyshemene teknologjike gjate gjitha gjatesise se tubit te drenazhimit te njesise ftohese.

Specifikimet teknike duhet te jene si meposhte:

Parametrat e dedektorit te prezences se ujit	
Lloji i dedektorit	Linear me gjatesi dedektimi minimalisht 3m
Dedektim	Autoamtik
Temperatura e operimit	Nga -20 °C deri ne +60 °C
Furnizimi me energji	Nga kontrolleri

### **Dedektore Tymi**

Ne tavanin e dhomes do te instalohet nje dedektor tymi, i cili do te sinjalizoj nepermjet sirenes, nepermjet emaile, dhe nepermjet SMS, nese ne dhome dedektohet tym. Ky dedektor, pervecse do jete pjese e sistemit te monitorimit dhe kontrollit, do te funksionoje edhe si njesi autonome. Pra duhet te kete bateri te integruar, ndricues LED per sinjalizim, sirene akustike, dhe buton test te integruara.

Specifikimet teknike duhet te jene si meposhte:

Parametrat e dedektorit te tymit	
Lloji i dedektore	Fotoelektrik
Sinjalizues per statusin	LED
Furnizim me energji	Nga paneli
Bateri	Per “backup” te energjise
Sirene te integruar	Alarm 85 db ne 3 m
Buton per testim te integruar	Gjate kohes qe butoni mbahet shtypur dedektori duhet te gjeneroj alarm

### **Sirena e Alarmit**

Sirena qe do te instalohet ne hyrje te dhomes se serverave, duhet te gjeneroje alarm akustik dhe vizual. Specifikimet e sirens, duhet te jene si meposhte:

Parametrat e sirenes	
Lloji i alarmit	Akustik dhe vizual
Niveli i alarmit akustik	100+/-3dB ne distance 1m
Niveli i alarmit vizuar	400x ne minute, ndricues LED i ndritshem

### **Lexuesi RFID per deren**

Ne hyrje ted homes se serverave do te instalohet nje lexues RFID per te lejuar aksesin e kontrolluar ne dhomen e serverave. Hyrje ne dhome do te behet me karte, ndersa dalja nga dhoma do te behet me nje buton “push to exit”.

Specifikimet teknike te lexuesit duhet te jene si meposhte:

Parametrat e lexuesit	
Teknologjia	EM, HID prox. (125 kHz) dhe MIFARE
Protokolli i komunikimit	Wiegand
Tregues statusi	Ndricues Led dhe sinjalizim akustik
Furnizimi me energji	Nga kontrolleri, ose moduli I/O
Montimi	I pershtatshem per ne mure
Mbrojtja IP	IP55 dhe IK07

### **Brava elektromagnetike**

Ne deren e dhomes se serverave do te instalohet nje brave elektromagnetike, per lejuar aksesin ne dhome vetem kur hyrja autorizohet nga karta e aksesit. Brava elektromagnetike duhet te kete nje force mbajtese 3500N (350kg). Brava duhet te kete sinjalizues led per te treguar statusin, hapur, mbyllur. Duhet te furnizohet me energji nga kontrolleri.

### **Softi i Operimit**

Softi i operimit duhet te kete karakteristikat e meposhteme:

- Duhet te suportojte shtimin dhe integrimin e paisjeve nepermjet ModBUS, BACnet, SNMP, ONVIF.
- Duhet te lejoje monitorimin dhe menaxhimin, dhe personalizimin e nderfaqes nepermjet HTML5.
- Duhet te lejoje ndertimin e planimetrise se dhomes me te gjitha komponentet e sajë dhe shfaqjen e parametrave per secilen komponente ne planimetri.
- Duhet te lejoje integrimin e sistemit te dedektimit te zjarrit (qe eshte pjese e ketije projekti), por te kete mundesi dhe per shtimin e sistemit te shuarjes se zjarrit ne te ardhmen.
- Duhet te lejoje integrimin e sistemit te kontrollit te aksesit (te marr statuset e sistemit hyrje/dalje, te mundesoje krijimin e te drejteva te aksesit per cdo perdorues, te mundesoje ndarjen ne grupe, te ruaje historikun).
- Duhet te lejoje integrimin e sistemit CCTV, per monitorim ne kohe reale dhe video rregjistrim.
- Duhet te kete mundesi per monitorimin e paisjeve si Njesi Ftohese, UPS, apo Gjenerator, per te kontrolluar konsumin e energjise elektrike.
- Duhet te mundesoje monitorimin e te gjithë sensoreve ne dhome, dhe shfaqjen e vlerave te tyre ne planimetri.
- Duhet te njoftoje ne kohe reale per cdo alarm, nepermjet e-Mail, SNMP, apo nepermjet SMS (duke derguar njoftimin ne nje SMS Gateway).

### **Rrjeti Elektrik**

Rrjeti elektrik përfshin instalimin e një paneli elektrik brenda në dhomën e serverave, furnizimin me energji elektrike të paisjeve që do të instalohen në dhomë, një UPS me kapacitet 3kW, si edhe shpërndareshit të energjisë që do të montohen në kabinet.

### **Paneli Elektrik dhe Linjat**

Brenda dhomës së serverave do të instalohet një panel elektrik me 24 module, i montueshem në mure (jashtë murit). Brenda panelit do të instalohen.

- 1 x automat 125A 2P: automat kryesor
- 1 x automat 32A 2P: për furnizimin e rack direkt ngalinja
- 1 x automat 32A 2P: për furnizimin e UPS
- 1 x Automat 32A 2P: për furnizimin e njesise ftohese
- 1 x Automat 16A 2P: për furnizimin e sistemit të aspirimit/ventilimit

Linja elektrike nga automati i furnizimit direkt nga linja, do të jete 3x2.5mm, dhe do të terminohet brenda kabinetit në një prizë industriale ku do të lidhet PDU (shpërndareshi i fuqisë direkt nga rrjeti). Linja elektrike që vjen nga automati për furnizimin e UPS, do të jete 3x2.5mm, dhe do të terminohet direkt në UPS që do të montohet brenda në rack.

Linja elektrike për furnizimin e njesise ftohese do të jete 3x2.5mm, dhe do të vijë nga automati për furnizimin e njesise ftohese dhe do të terminohet direkt në bllokun e ushqimit të njesise ftohese.

Linja elektrike për furnizimin e sistemit të ventilimit, do të vijë nga automati i ventilimit dhe do të shkojë tek ventilatori centrifugal dhe aksial.

Lloji i kabllave që do të përdoren do të jete FG7OM1.

Kabllot elektrike nga paneli elektrik deri në rack do të kalojnë nga sipër kabinetit, me kanline metalike. Ndërsa kabllot elektrik për sistemin e ventilimit do të kalojnë me tuba rixhid me diametër 25mm.

### **UPS (Burimi i Panderprerë i Energjisë)**

U.P.S. duhet të jete me kapacitet 6kVA, tension 1 fazor hyrje dhe 1 fazor dalje, dopio konvertim online, 10 min autonomi me bateri të brendshme në 70% ngarkesë. U.P.S. duhet të ketë faktor fuqie 1m duhet të ketë diapazon të gjërë të tensionit dhe frekuencës në hyrje, në mënyrë që të funksionojë në rrjet me luhajtje dhe të mundësojë lidhjen me gjenerator. U.P.S. duhet të lejojë shtimin e baterive të jashtme për rritjen e autonomisë. Duhet të ketë ekran LCD për monitorim dhe konfigurim lokal, si edhe duhet të ketë kartë rrjeti për operim në distancë dhe integrim me softin e operimit të BMS. U.P.S. duhet të jete e montueshme në rack, dhe me lartësi 2RU.

Me poshtë jepen specifikimet teknike të UPS:

Parametrat e U.P.S.	
Teknologjia	Online
Kapaciteti	6kVA/6kW
Faktori i Fuqisë në Dalje	1.0
Diapazoni i Tensionit në Hyrje	110-300 VAC në ngarkesë 0-60% 140-300 VAC në ngarkesë 60-80% 176-300 VAC në ngarkesë 80-100%
Shtremberimi i Harmonikës në	≤4% në ngarkesë 100%

Hyrje	≤6% ne ngarkese 50%
Faktori i Fuqise ne Hyrje	>0.99 ne ngarkese te plote
Diapazoni i Frekuences ne Hyrje	46Hz - 54Hz ose 56Hz - 64Hz
Tensioni Nominal ne Dlaje	208/220/230/240 VAC
Rregullimi i Tensionit ne Dalje	±1%
Rregullimi i Frekuences ne Dalje	±0,1Hz
Koha e transferimit AC ne Bateri	0ms
Koha e transferimit Inverter ne Bypass	0ms
Kapaciteti i Mbingarkeses	Ne linje: 10minunta ne 100%-110%; 1minute ne110%-130%; 1s ne me shume se 130%; Ne bateri: 30s ne100%-110%; 10s ne110%-130%; 1s ne me shume se >130%
Shtim baterishe te jashteme	Po
Lidhje ne paralel te dy apo me shume njesive	Po
Eficensa ne ngarkese te plote (ne linje)	Min. 94.0%
Eficensa ne ngarkese te plote (ne bateri)	Min. 91.0%
Bateri te brendeshme	Min. 20 x 12V/9Ah
Autonomia	Min. 6min ne ngarkese te plote dhe 17 min ne 50% ngarkese
Hyrja e furnizimit te U.P.S.	Me terminale
Dalja e UPS	Me terminale
Porte USB	Po
Porte RS232	Po
Porte EPO	Po
Karte SNMP	Po
Montimi	Ne Rack, 2RU

### **Shperndaresit e Energjise (PDU)**

Ne kabinet do te instlohen dy PDU, njera per furnizimin me energji direkt nga rrjeti, dhe tjetra per furnizimin nga UPS. PDU do te jene nje fazore, me kapacitet 32A, dhe do te montohen vertikalisht ne te dy anet e kabinetit, ne pjesen e pasme.

Hyrja e PDUve duhet te jete IEC EN60309, dhe secila PDU do te kete 20 dalje Shucko te ndara ne 2 grupe.

### **Kanalinat e Verdha**

Kanalinat e verdha do te perdoren per kalimin e kablllove te bakrit (data) dhe kablllove te sinjalizimit, nga secila paisje drejt kabinetit. Kanalina do te montohet mbi kabinet, duke perdorur strukture mbajtese qe montohet ne tavanin e dhomes. Kanalina duhet te jete e paisur me te gjitha aksesoret per montim, bashkues, tapa fundore, si edhe aksesoret e zbritjes ne kabinet.

**Specifikimet e kanalines duhet te jene si me poshte:**

Parametrat e kanalines se verdhe	
Gjatesia e kanalines	Shufra standard 2m, te kete mundesine e bashkimit
Dimensionet	160x100mm
Ngjyra	E verdhe
Aksesoret	Tapa fundore, bashkues, aksesore zbritje mbi kabinete, suporte qe kapen mbi kabinete dhe ku fiksohet prizhonieri, prizhonier, mbajtese horizontale e kanalines se verdhe.

**Kanalinat metalike**

Kabllot elektrike do te kalohen mbi kabinete duke perdorur kanaline metalike me dimensione 200x60mm. Kanalina do te shtrihet sipas planimetrise se dhene me lart, dhe do te kapet me prizhonier ne tavan. Kanalina duhet te kete te gjitha aksesoret si kthesa, bashkues, dhe aksesore montimi.

**Sistemi CCTV**

Ne dhomen e serverave do te instalohet nje sistem CCTV per te monitoruar aktivitetin brenda dhe jashte dhomes. Sistemi qe do te instalohet duhet te jete IP, me rezolucion 5Mpixel. Brenda ne dhome do te instalohen dy kamera, te vendosura diagonalisht si ne planimetrine e dhene me lart. Nje kamera do te vendoset jashte deres se dhomes, per te monitoruar hyrje/daljet ne dhome. Kamerat do te rregjistrojne gjate gjithë kohes ne nje NVR me 4 kanale, te paisur me HDD per te ruajtur per minimalisht 30 dite videot me rezolucion maksimal dhe 10 fps.

Sistemi CCTV do te integrohet me sistmin e kontrollit dhe menaxhimit, ne menyre qe sistemi i kamerave te monitorohet nga i njejti software operimi.

**Kamerat IP**

Kamerat qe do te insalohen per monitorimin e dhomes se serverave duhet te jene te formatit dome, teknologji IP dhe me rezolucion 5Mpixel. Kamerat duhet te jene te paisura me IR, dhe te kene funksione analitike te integruara.

Specifikimet teknike te kamerave jepen si meposhte:

Parametrat e Kamerave	
Teknologjia	IP
Forma	Kamera dome
Rezolucioni	5Mpixel
Lente	2.8mm/F2.0
Sensori	skanim progresiv CMOS ½.8”
Ndricimi minimal	Me ngjyra: 0.005Lux@F1.2 Bardhe e zi: 0Lux me ndricimin IR te ndezur
Fushepamja	H113°/D144°/V84°
Koha e shkreptes	1/100000s~1s
Distanca e IR	Deri ne 25m
Raporti Sinjal/Zhurme	>55dB
Rezolucioni maksimal	2592x1944
Numri i transmetimeve video	3
Kompresimi Video	H.265+/H.265(HEVC)/H.264+/H.264/MJPEG
Bit rate	16Kbps~16Mbps(CBR dhe VBR)
Porte ethernet	1 x RJ45 10M/100M
Storage Lokal	MicroSD deri ne 256GB
Funksione te avancuara	Maski per privacine, BLC, HLC, 2D DNR, 3D DNR, ROI, Defog, AWB, EIS, filtrim te adresave IP, AGC, Anti-flicker, Corridor Mode, Deblur, Watermark
SIP/VoIP	Po, voice dhe video mbi IP
Funksioneve Analitike	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Hyrja ne nje zone te caktuar</li> <li>▪ Dalja nga nje zone e caktuar</li> <li>▪ Dedektim i levizjeve</li> <li>▪ Dedektimin e ngacmimeve/mashtimit te kameras</li> <li>▪ Kalimin e nje vije</li> <li>▪ Sorollatjen ne nje zone te caktuar</li> <li>▪ Dedektimin e njerezve</li> <li>▪ Numrimin e njerezve</li> <li>▪ Dedektimin e objekteve te braktisura</li> <li>▪ Heqjen e objekteve nga nje zone e caktuar</li> </ul>
Aktivizimin e nje alarmi nga	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dedektimi i levizjeve</li> <li>▪ Shkeputja nga rrjeti</li> <li>▪ Alarm Audio</li> <li>▪ Ose nga nje prej funksioneve analitike te permendura me lart</li> </ul>
Veprimet ne rast alarmi	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Te ngarkojne video/imazhe ne nje FTP Server</li> <li>▪ Te dergojne video/iamzhe me email</li> <li>▪ Te kryejne nje thirrje telefonike VoIP drejt nje numri te caktuar</li> <li>▪ Te ruajne video/imazhe ne nje SD card</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Te gjeneroje nje alarm ne VMS</li> </ul>
Kompatibiliteti	ONVIF profilet G, Q, S dhe T
Furnizimi me enrgji	PoE (802.3af)
Kasa	Metalike, antivandale, e certifikuar IK10, dhe me mbrojtje IP67.
Aksesore montimi	Kamera duhet te kete te perfshire kit per instalim ne mure (strukture vertikale), ose per ne tavan. Kiti i montimit duhet te jete metalik, dhe i te njejtit prodhues me kameran.

### **Video Rregjistratori i Rrjetit**

Video rregjistratori qe do te instalohet duhet te jete i montueshem ne rack, minimalisht duhet te kete 4 kanale, dhe switch te integruar me minimalisht 4 porta PoE.

Video rregjistratori duhet te kete nje dalje HDMI dhe nje dalje VGA, duhet te lejoje rregjistrim sinkron per te gjitha kamerat (kanalet qe ka), duhet te lejoje “playback” sinkron per te gjitha kamerat me 30fps, duhet te kete nje porte “Uplink” 10/100/1000Mbps.

### **Specifikimet teknike te video rregjistratorit jepen si me poshte:**

Parametrat e Video Rregjistratorit	
Teknologjia	IP
Forma	E montueshme ne rack
Kanalet	Minimalisht 4
Switch PoE i integruar	Minimalisht 4 porta
Daljet video	1 x HDMI 1 x VGA
Rezolucioni i rregjistrimit	5MP/4MP/3MP/1080P
Kompresimi Video	H.265+/H.265(HEVC)/H.264+/H.264/MJPEG
Hapesira e ruajtjes	2 x HDD me kapacitet 2 TB te instaluar
Rregjistrimi sinkron	Minimalisht 4 x 5Mpixel
Lloji i rregjistrimit	I vazhdueshem, ose i aktivizuar nga nje ngarje
Nderfaqe rrjeti	1 x RJ45 10/100/1000Mbps
Porta USB	Minimalisht 3 (mouse, tastjere, storage i jashtem)
Dalje audio	1 x RCA
Hyrje Alarmi	Minimalisht 4 kanale
Dalje Alarmi	Minimalisht 1
Funksioneve Analitike	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Hyrja ne nje zone te caktuar</li> <li>▪ Dalja nga nje zone e caktuar</li> <li>▪ Dedektim i levizjeve</li> <li>▪ Dedektimin e ngacmimeve/mashtimit te</li> </ul>



	kameras <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Kalimin e nje vije</li> <li>▪ Sorollatjen ne nje zone te caktuar</li> <li>▪ Dedektimin e njerezve</li> <li>▪ Numrimin e njerezve</li> <li>▪ Dedektimin e objekteve te braktisura</li> <li>▪ Heqjen e objekteve nga nje zone e caktuar</li> </ul>
Kompatibiliteti	ONVIF profilet G, Q, S dhe T
Furnizimi me enrgji	AC 100V~240V 50Hz~60Hz

### **Rrjeti Data per sistemin CCTV**

Rrjeti i transmetimit te kamerave do te realizohet me kabell rrjeti Cat.6A FTP. Te gjitha kabllot do te shtrihen nga secila prej kamerave deri ne kabinet, duke perdorur tuba rixhid me diameter 25mm deri ne kryqezimin e tubit me kanalinen e verdhe, dhe pastaj ne kabinet do te shkojne nepermjet kanalines se verdhe. Ne te dy krahet (ne kamera dhe ne NVR), kabllot do te terminohen ne konektor RJ45. Kabllot duhet te jene te etikuar ne te dy anet.

**Shtojca 11**

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktornë Marrëveshjen Kuadër]

**PLANIFIKIMI I  
KONTRATAVENËMARRËVESHJENKUADËR**

<input type="checkbox"/> Mall:	Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër	
_____		
<b>Kontrata Nr.</b>	<b>Titulli i Kontratës</b>	<b>Përshkrim i shkurtër i kontratës</b>
<b>01</b>	_____	_____
<b>02</b>	_____	_____
<b>03</b>	_____	_____
<b>...</b>	_____	_____

## Shtojca 12

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë nërastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatërihapjes sëprocesit tëmini-konkursit)

### SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

#### LOTI – 1

#### Furnizim -Vendosje Servera dhe Sistem Storage për Ujësjetës Kanalizime Lushnje Sh.a.

Sasia e mallit që kërkohet:

NR.	EMËRTIMI I MATERIALIT	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI PËR NJËSI	VLERA
	<b>Loti nr. 1</b>				
1.	Server me dy procesorë	Copë	2	-	-
2.	Sistem Storage Qëndror	Copë	1	-	-
3.	Backup appliance me software përkatës	Set	1	-	-
4.	Switch L3 me 24 porta	Copë	1	-	-
5.	Router Firewall	Copë	1	-	-
6.	Shërbimet e implementimit dhe migrimit të të dhënave	Copë	1	-	-
	<b>TOTALI</b>			-	-
	<b>TVSH</b>			-	-
	<b>TOTALI ME TVSH</b>			-	-

## Shtojca 12

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë nërastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatërihapjes sëprocesit tëmini-konkursit)

### SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

#### LOTI – 2

#### Rikonstrukcion i Dhomës së Serverave të Sh.a Ujësjellës Kanalizime Lushnje Sh. a.

#### PREVENTIVI :

NR.	PERSHKRIMI I MATERIALEVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI PËR NJËSI	VLERA
01	Sistem Monitorimi Server Room-i (BMS)	Cope	1	-	-
02	Sistem Shuarje Zjarri ,Clean Agent Fire NOVEC 3M 1230	Cope	1	-	-
03	Sistem Ftohje, Super Inverter DC 18BTU	Cope	1	-	-
04	Riparim Sistemi Elektrik, Kabllosje, Aksesori	Cope	1	-	-
05	PDU (6 outpute)	Cope	2	-	-
06	Punime te tjera si ndriçimi i ambientit(ndriçimi i emergjences,piktura,riparim sistemi elektrik,instalimi i deres rezistente ndaj	Cope	1	-	-

	zjarrit dhe anti panik , heqja e pajisjeve ekzistuese si dhe rilyerje)				
<b>07</b>	Përforcimi i mureve ekzistuese me pllaka dhe pajisje metalike dhe tavan me fletë betoni rezistente ndaj zjarrit, pajisje, montim	Cope	1	-	-
<b>08</b>	UPS	Cope	2	-	-
<b>09</b>	Sistem Kamerash CCTV NVR 4porta PoE x1, IP Kamera Dome 4mpx x3, HDD 2TB	Cope	1	-	-
<b>TOTAL PA TVSH</b>					-
<b>TOTAL ME TVSH</b>					-

**Shtojca 13**

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

**NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR<sup>4</sup>**

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006“Për Prokurimin Publik”.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

---

---

---

---

---

---

---

---

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

< **Emri** >

---

<sup>4</sup> Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

## Shtojca 14

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### FORMULARI I NJOFTIMIT TËFITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

\* \* \*

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës nëprocedurë këta ofertues me vlerat përkatëse tëofruara:

1. \_\_\_\_\_

Emri i plotë i shoqërisë

\_\_\_\_\_

numri i NIPT-it

Vlera \_\_\_\_\_

(me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_

Emri i plotë i shoqërisë

\_\_\_\_\_

numri i NIPT-it

Vlera \_\_\_\_\_

(me numra dhe fjalë)

Etj. \_\_\_\_\_

Janëskualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_

Emri i plotë i shoqërisë

\_\_\_\_\_

numri i NIPT-it

2. \_\_\_\_\_

Emri i plotë i shoqërisë

\_\_\_\_\_

numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

---

---

---

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [*shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*]/pikët totale të marra[\_\_\_\_\_]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimine kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006“Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

\* \* \*

[ Titullari i autoritetit kontraktor]



## Shtojca 15

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

\* \* \*

Procedura e prokurimit: \_\_\_\_\_

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:  oferta ekonomikisht më e favorshme  çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsytet e mëposhtme:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

Etj.\_\_\_\_

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

**[Titullari i autoritetit kontraktor]**

## Shtojca 16

### **KUSHTET E PËRGJITHSHME Mallrat – Tender i Hapur**

#### **Neni 1: Qellimi**

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e Mallrave të prokuruarra me anë të procedurës me negociim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

#### **Neni 2: Përkufizime**

- 2.1 “kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga Dokumentat e Tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha shtojcat dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Incoterms” do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë detyrimet përkatëse, kostot, dhe risqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga shitësi tek blerësi.
- 2.4 “Lëvrimi” do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi,

tarifat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi, instalimi, mbledhja, bashkimi, kontrollimi i veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.

- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen Mallrat. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktuesi” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon Mallrat.
- 2.7 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.8 “Mallrat” do të thotë materialet e papërpunuara, produktet, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë, të lëngshme ose të gaztë.
- 2.9 “Shërbimet e lidhura me to” do të thotë shërbimet ndihmëse ose të paparashikuara të furnizimit të Mallrave, si transportimi, instalimi, mirëmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e Mallrave.
- 2.10 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Mallrat dhe Shërbimet e lidhura me to që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.11 “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një organ i posaçëm standardizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

### **Neni 3: Hartimi i Kontratës**

- 3.1 Njoftimi i ofertës fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

### **Neni 4: Praktikët e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ndonjë ent tjetër që ka marrë pjesë në përgatitjen e Dokumentave të Tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

### **Neni 5: Informacioni Konfidencial**

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t'i japë nënkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar për nënkontraktuesin të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nën-Kontraktuesin një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

### **Neni 6: Pronësia Intelektuale**

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetin Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Kontraktuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i parashtojë Autoriteti Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdorë për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të shkarkojë Autoritetin Kontraktor ngapërgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronësisë intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose shpërndarja e Mallrave sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronësisë intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i Mallrave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

### **Neni 7: Origjina e Mallrave**

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së mallrave, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktuesi mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e mallrave.
- 7.3 Për qëllime verifikimi, "origjinë" do të thotë vendi ku mallrat janë nxjerrë, ose prodhuar. Mallrat janë prodhuar kur, nëpërmjet përpunimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezultojnë një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.

- 7.4 Origjina e mallrave ka dallim nga kombësia e Kontraktuesit ose nenkontraktuesit që siguron mallrat.

#### **Neni 8: Qëllimi i Furnizimit dhe Përshtatshmëria e Mallrave me Specifikimet**

- 8.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat në përputhje me cilësinë, sasinë dhe llojine specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
- 8.2 Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën, nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin e posaçëm të parashikuar në kontratë. Kur nuk është e mundur të përcaktohet një gjë e tillë, thuhet se Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin për të cilin shërbejnë zakonisht sendet e tjera të të njëjtit lloj.
- 8.3 Nëse shitja është bërë në bazë të një modeli ose kampioni, shitësi (Kontraktuesi) duhet të dorëzojë sendet që kanë të njëjtat cilësi si të modelit ose kampionit.

#### **Neni 9: Përputhshmëria e Mallrave me Standardet Teknike**

- 9.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konform kodeve dhe Standardeve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet përkatëse ose në Standardet Teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktor.
- 9.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë dispozite tjetër e kontratës, kur nuk është përcaktuar asnjë Standard Teknik përkatës në specifikimet teknike, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike ndërkombëtare. Nëse nuk ekzistojnë Standarde Teknike ndërkombëtare, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike përkatëse Shqiptare.
- 9.3 Kontraktuesi nuk mban përgjegjësi për gabime në skicim, të dhëna, vizatim ose çdo aspekt tjetër të specifikimeve teknike të dhëna nga Autoriteti Kontraktor me përjashtim të rastit kur gabimi ishte aq i dukshëm sa Kontraktuesi duhet ta kishte parë dhe këshilluar Autoritetin Kontraktor për të.
- 9.4 Shitësi (Kontraktuesi) nuk mban përgjegjësi për defekte të Mallrave për të cilat Autoriteti Kontraktor ishte në dijeni në momentin e lidhjes së kontratës ose nuk ishte në dijeni për faj të tij, me përjashtim të rastit kur defektet kanë të bëjnë me cilësinë e Mallrave të specifikuar sipas kontratës ose përfaqësimin e reklamës së shitesit (Kontraktuesit).

#### **Neni 10: Pjesët e Këmbimit**

- 10.1 Nëse është e parashikuar nëkontratë, Kontraktuesi duhet të përfshijë me Mallrat e lëvruara një sasi pjesësh këmbimi, në përputhje me specifikimet teknike dhe çdo dispozitë përkatëse të kontratës.
- 10.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe, pjesët e këmbimit do të dorëzohen bashkë me Mallrat.

